



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1064

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga **XX** duke vendosur sipas ankesës së OE “Arsimi Company” SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00€” me numër të prokurimit 617-25-3546-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SHTIME”, më 24/11/2025, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Arsimi Company” SH.P.K. me nr. 2025/1064 , e datës 29/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00 €”, me numër të prokurimit 617-25-3546-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SHTIME”.

II. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00 €”, me numër të prokurimit 617-25-3546-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SHTIME”. **AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.**

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.09.2025, “KOMUNA SHTIME”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi per kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00€” me nr.prokurimi: 617-25-3546-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 410,000.00 €.

Me 15.10.2025, OE “Arsimi Company” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.10.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.10.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Arsimi Company” SH.P.K., me nr. 2025/1064 lidhur me aktivitetin “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00€” me numër të prokurimit: 617-25-3546-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arsimi Company” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor Nr. 1 “Rimorkio sinjalizuese për punime në rrugë me gjenerator me regjistrim valid (2 copë)”

Ky kriter teknik i vendosur nga Autoriteti Kontraktues është i pajustificueshëm, i panevojshëm dhe kufizues, në raport me natyrën reale të projektit dhe parimet bazë të prokurimit publik, të garantuara me nenin 7 dhe 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Nga përmbajtja e paramasës dhe parallogarisë, është e qartë se projekti përfshin:punime të karakterit ndërtimor dhe asfaltues në një segment të kufizuar rrugor, ku kërkesat për sinjalizim janë të përkohshme dhe mund të realizohen përmes pajisjeve standarde sinjalizuese(sic janë: panele vertikale, shenja të përkohshme, trekëndësha paralajmërues, drita paralajmëruese etj.).

Pra këto pajisje janë plotësisht të mjaftueshme për të garantuar siguri në punishten rrugore, siç parashihet edhe në Rregulloren për sinjalizimin e përkohshëm në punime rrugore të Ministrisë së Infrastrukturës.

Dhe, kërkesa që rimorkioja sinjalizuese të ketë gjenerator të integruar dhe të jetë e regjistruar, përbën një kriter teknik të tepruar dhe kufizues, sepse:

Nuk është kriter që ndikon në cilësinë e punimeve ndërtimore apo asfaltuese, ky është mjet ndihmës për sinjalizim, jo pajisje operative ndërtimi, prandaj specifikimi i komponentëve shtesë si “gjeneratori i integruar” nuk e përmirëson kualitetin apo rezultatet e projektit,

Shihet haptazi që kriteri është i ndërtuar për një operator të caktuar, pasi pajisje të tilla (rimorkio me gjenerator të integruar dhe regjistrim valid) janë të rralla në tregun vendor dhe posedohen vetëm nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Kjo automatikisht kufizon konkurrencën dhe pengon pjesëmarrjen e operatorëve tjerë, të cilët posedojnë rimorkio sinjalizuese funksionale por pa këtë komponent shtesë.

AK, duke e kufizuar pjesëmarrjen, bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive, të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, si dhe me nenin 28 paragrafi 1.2, i cili obligon autoritetet kontraktuese që kërkesat teknike të jenë në përputhje me natyrën dhe qëllimin e kontratës, dhe të mos përjashtojnë operatorë të tjerë potencialë pa arsye të arsyeshme.

Në vendimin e Kërkesës për ri-shqyrtim AK potencon që kriteret janë “minimale dhe profesionale” është i pa-bazuar, sepse profesionalizmi teknik nuk matet me ekzistencën e një gjeneratori në rimorkio, por me zbatimin e standardeve të sinjalizimit rrugor dhe me sigurimin e kushteve për punë të sigurt.

Ky kriter, në fakt, ka efekt të kundërt me qëllimin e deklaruar sepse pengon konkurrencën dhe rrit artificialisht çmimin, pasi numri i operatorëve që i plotësojnë këto kërkesa është i kufizuar, duke krijuar terren për çmime jo reale dhe jo konkurruese.

Gjithashtu kriteri dëmton interesin ekonomik të Autoritetit Kontraktues, sepse kufizimi i konkurrencës automatikisht redukton mundësinë për të marrë ofertën me çmimin më të lirë që është një nga objektivat themelore të prokurimit publik sipas nenit 1 të LPP-së.

Vendosja e kërkesës për “rimorkio sinjalizuese me gjenerator të integruar dhe regjistrim valid”:

nuk ka arsyetim teknik në raport me natyrën e projektit;

krijon pengesa të panevojshme për konkurrencë të lirë;

favorizon operatorë të caktuar;

dhe bie ndesh me nenet 7, 28 dhe 59 të LPP-së, që garantojnë barazi, transparencë dhe përdorim efikas të fondeve publike.

Kërkojmë që OSHP, në bazë të kompetencave të saj ligjore, të konstatojë se kriteri në fjalë është i pajustificueshëm dhe diskriminues, dhe të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të bëjë modifikimin përkatës, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve që posedojnë rimorkio sinjalizuese funksionale për sinjalizim në punime rrugore, pa u kushtëzuar me ekzistencën e gjeneratorit të integruar ose regjistrimit valid.

Pretendimi numer 2: “Kamion kipper 4x4 me vinç me peshë bartëse deri 5–7 ton (1 copë).”

Kriteri që kamioni të jetë 4x4 (me lëvizje në të gjitha rrotat) është pa asnjë lidhje logjike dhe teknike me natyrën e projektit.

Punimet e asfaltimit dhe ndërtimit rrugor, sipas paramasës së projektit, zhvillohen në rrugë ekzistuese ose segmente të përgatitura, ku qasja është e lehtë dhe nuk kërkon mjete për terrene të vështira apo të paarrtshme. Në këto kushte, një kamion standard 4x2 është plotësisht adekuat dhe funksional për transportin e materialeve ndërtimore dhe operacionet ndihmëse.

Vendosja e kushtit për konfigurim 4x4 është një kufizim artificial, që:

Redukton ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që mund të konkurrojnë,

Krijon avantazh të pashpjegueshëm për një numër shumë të vogël operatorësh që posedojnë mjete të tilla të specializuara,

Dhe si rezultat, shkatërron konkurrencën reale në procesin e ofertimit.

Po ashtu, kërkesa që vinçi i integruar të ketë peshë bartëse vetëm 5–7 ton është interval kufizues dhe i pajustificuar teknikisht. Një operator që posedon vinç me kapacitet pak më të madh (p.sh. 8–10 ton) nuk ka asnjë arsye të përjashtohet, sepse ai mjet në mënyrë objektive mund të përmbushë dhe tejkalojë funksionin e kërkuar.

Kjo tregon qartë se kriteri nuk është hartuar për të përmbushur nevojën e projektit, por për të ngushtuar konkurrencën në mënyrë selektive.

Në përputhje me nenin 28.1.2 të LPP-së, kërkesat teknike duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të mos kenë efekt kufizues në konkurrencë gjë që në këtë rast është shkelur flagrantisht.

Kriteri në fjalë me patjetër duhet të modifikohet në mënyrë që të lejojë përdorimin e kamionëve transportues me kapacitet të përshtatshëm për punime ndërtimore rrugore, pavarësisht konfigurimit të boshtit (4x2 apo 4x4), për sa kohë që përmbushin funksionin transportues dhe teknik përkatës.

Pretendimi Ankimor numer 3: “Kamion kipper me peshë bartëse maksimum 1 ton (1 copë).”

Kërkesa për një kamion kipper me bartje vetëm deri në 1 ton në një projekt asfaltimi rrugor përbën një absurditet teknik dhe operacional, pa asnjë arsyetim funksional në raport me llojin e punimeve që do të kryhen.

Në praktikën profesionale të punimeve rrugore, një kamion i tillë nuk ka kapacitetin teknik për të kryer ndonjë detyrë reale ndërtimore, si transporti i zhavorrit, asfaltit, materialeve bituminoze etj.

Një kamion me bartje 1 ton është mjet i vogël, i cili përdoret zakonisht për punë dytësore (bartje veglash, materiale të lehta ose mbetje), dhe jo për operacione ndërtimore që kërkojnë kapacitete reale transportuese.

Vendosja e këtij kriteri nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit:

- perjashton pa arsye logjike operatorët që posedojnë flotë standarde ndërtimore

- nuk ka justifikim teknik në raport me natyrën e punimeve,
- kufizon ndjeshëm konkurrencën në treg,
- zvogëlon presionin konkurrues,
- dhe rrjedhimisht, krijon rrezik për çmime artificialisht të larta, në kundërshtim me qëllimin themelor të prokurimit publik për vlerë optimale për para.

Ky kriter bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), të cilët ndalojnë çdo kërkesë që nuk është objektivist e nevojshme për realizimin e kontratës dhe që pengon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të tjerë

Përgjigjja standarde e Autoritetit Kontraktues (Komuna Shtime) se “kriteret janë të mbështetura në paramasë dhe parallogari, minimale dhe profesionale”, është thjesht një përgjigje formale pa arsyetim teknik konkret. Nëse një pajisje e tillë do të ishte realisht e nevojshme për projektin, do të duhej të ekzistonte arsyetimi teknik përkatës në dokumentacionin e projektit.

Në mungesë të tij, kriteri është arbitrar, diskriminues dhe në kundërshtim me parimet themelore të barazisë dhe konkurrencës.

Referim në vendimin ekzistues të OSHP-së

Në këtë drejtim, është me rëndësi thelbësore të theksohet se një çështje identike është trajtuar dhe gjykuar më parë nga OSHP-ja, konkretisht në Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 2025/0268.

Në këtë rast, OSHP ka marrë në shqyrtim të njëjtin pretendim lidhur me kërkesën e një “kamioni kipper me peshë bartëse maksimum 1 ton”, dhe pas vlerësimit profesional, ka pranuar si të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik.

Në faqen 10 dhe 11 të raportit të ekspertizës teknike të këtij vendimi, eksperti teknik e ka rekomanduar qartësisht që:

“Autoriteti Kontraktues të bëjë korigjimin dhe modifikimin e kërkesës dhe të njëjtën ose ta largojë nga dosja e tenderit, ose të rrisë kapacitetin e tonazhës në mënyrë që të lejojë konkurrencën më të gjerë, me përshkrimin ‘Kamion kipper me peshë bartëse deri në 3.5 ton’.”

Ky rekomandim teknik, i pranuar nga paneli i OSHP-së, përbën një precedent të qartë administrativ dhe profesional mbi këtë çështje.

Pra, një organ i pavarur dhe kompetent, pas shqyrtimit të ekspertizës profesionale, ka konstatuar se përcaktimi i kufirit 1 ton është teknikisht i pajustificuar dhe kufizues për konkurrencën

Në këtë rrethanë, nuk ekziston asnjë bazë ligjore dhe profesionale që një autoritet tjetër kontraktues (si Komuna e Shtimes) të përsërisë një kriter identik që është shfuqizuar më parë nga OSHP-ja

Lejimi i një praktike të tillë do të krijonte mungesë koherence, trajtë të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse për një çështje identike, OSHP nuk mund të japë vendime kontradiktore

Përfundimisht kërkojmë nga OSHP-ja q

Të konstatojë se kriteri për “Kamion kipper me peshë bartëse maksimum 1 ton” është i panevojshëm, i pajustificuar dhe kufizues

Të vlerësojë analogjinë me vendimin nr. 2025/0268, duke e konsideruar atë si precedent i detyrueshëm në kuptim të parimeve të barazisë së trajtimit dhe konsistencës administrative

Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues (Komuna Shtime) që ta modifikojë ose largojë këtë kërkesë, duke e zëvendësuar me formulimin profesionalisht të pranueshëm:

“Kamion kipper me peshë bartëse deri në 3.5 ton”

në mënyrë që të sigurohet konkurrencë e hapur, pjesëmarrje e barabartë dhe transparencë e plotë në procesin e prokurimit publik.

Pretendimi numer 4: “Grejder 10–11 ton (1 copë).”

Refuzimi i këtij pretendimi tone të paraqitur në kërkesën për ri-shqyrtim është jo vetëm formal, por edhe thelbësisht i pavlefshëm dhe pa asnjë mbështetje në prova teknike apo logjike

Argumenti i AK-së se “kërkesat janë të mbështetura në punët e paramasës dhe parallogarisë” është një përgjigje e përgjithshme, e paprovuar dhe e paargumentuar, që mund të përdoret për çdo rast, pa pasur lidhje konkrete me specifikimin në fjalë.

Në asnjë dokument teknik, plan apo analizë të çmimeve nuk ekziston ndonjë justifikim që kërkon ekskluzivisht grejder me peshë vetëm 10–11 ton. Kjo kërkesë artificiale nuk është një “kriter minimal profesional”, por një pengesë e qartë dhe selektive që synon përshtatjen e një mjeti të vetëm të tregut apo të një operatori të caktuar.

Një kufizim i tillë ekstrem, vetëm 1 ton diferencë, është irracional, sepse në praktikën e ndërtimit të rrugëve:

Grejderët nga 8 deri në 15 ton përdoren rregullisht për të njëjtat punime;

Pesha nuk është kriter përcaktues për efikasitetin, por fuqia, kapaciteti i tehut dhe konfigurimi teknik.Pra, ky kufizim

Nuk lidhet me natyrën e punimeve,

Nuk garanton cilësi më të mirë

MIRËPO kufizon pjesëmarrjen e operatorëve që kanë mjete të përshtatshme me peshë minimale më të ulët apo më të lartë.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues ka cenuar drejtpërdrejt nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke vendosur kriter që favorizon operatorë të veçantë dhe redukton konkurrencën reale në treg.

Konsiderojmë që kriteri në fjalë duhet të modifikohet urgjentisht duke lejuar grejder me “peshë të përshtatshme për punime rrugore” ose me interval më të gjerë (p.sh. 8–15 ton), në përputhje me parimin e

proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe barazisë së operatorëve ekonomikë.

Pretendimi Ankimor numer 5: “Gjysmë-rimorkio për shtrirjen e zhavorit të bankinave, minimum 2 ton (1 copë).”

Refuzimi i këtij pretendimi (në kërkesën për ri-shqyrtim) nga ZPP është po ashtu i pajustificuar, arbitrar dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, SEPSE:

Në asnjë dokument të paramasës apo parallogarisë nuk ekziston detyrë e tillë që kërkon mjet kaq specifik. AK-ja fshihet pas një fraze standarde pa treguar se cilat punime konkrete kërkojnë gjysmë-rimorkio të tillë..

Në fakt, në praktikën e zakonshme të ndërtimit rrugor dhe të mirëmbajtjes së bankinave:

Shtrirja e zhavorit realizohet me kamionë kipper standardë ose me mjetet ekzistuese ndërtimore, të cilat janë të mjaftueshme për sasinë dhe natyrën e punës, Gjysmë-rimorkiot e këtij lloji janë mjete të rralla, të specializuara dhe jo të domosdoshme, që vetëm disa kompani mund t’i posedojnë.

Ky kusht pra nuk është “minimal profesional” është kusht artificial që përjashton operatorët që nuk kanë këtë pajisje specifike, edhe pse posedojnë flotë të plotë për asfaltim rrugësh

Kështu, AK ka vendosur kriter diskriminues dhe joproportional, në kundërshtim me:

Nenin 7 (Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit)

Nenin 59 (Specifikimet teknike duhet të sigurojnë konkurrencë të drejtë dhe jo favorizim)

Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktues (AK) lidhur me përdorimin e Gjysmë-rimorkio për shtrirjen e zhavorit të bankinave, minimum 2 ton (1 copë).” është i pajustificuar dhe kufizues për konkurrencën. Ky kriter duhet të hiqet ose të zëvendësohet me një formulim më të përgjithshëm, si p.sh. “makinë/pajisje e përshtatshme për shtrirjen e zhavorit të bankinave”, duke lejuar operatorët ekonomikë të ofrojnë zgjidhje teknike ekuivalente dhe funksionalisht të përshtatshme.

Thelbi i kërkesës duhet të fokusohet në rezultatin profesional të punimeve sipas paramasës dhe kushteve të terrenit, e jo në llojin e pajisjes që përdoret. Ajo që ka rëndësi është që puna të realizohet në mënyrë cilësore, në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet përkatëse, pavarësisht nga marka apo tipi i pajisjes së përdorur.

Pretendimi Ankimor numer 6: “Eskavator me zingjir gome deri 1 ton (2 copë).”

Refuzimi i këtij pretendimi (të paraaqitur nga ana e jonë në kërkesën për rishqyrtim) është pa asnjë bazë teknike, logjike apo ligjore, dhe përbën një shkelje flagrante të parimeve themelore të prokurimit publik, të garantuara me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Kriteri në fjalë është absurd, diskriminues dhe krejtësisht i pajustificuar për disa arsye thelbësore:

Një eskavator me peshë deri 1 ton është praktikisht një mini-mjet për punime kopshtarie apo për hapje kanalesh shumë të cekëta në hapësira urbane, jo për punime infrastrukturore rrugore.

Në projektet e asfaltimit, madje edhe për bankinat apo kanalet anësore, përdoren eskavatorë nga 1.5 deri në 5 ton, që janë funksionalë dhe të përshtatshëm për vëllimin dhe thellësinë e punimeve të parashikuara.

Për rrjedhojë, ky kufizim “deri 1 ton” nuk reflekton realitetin teknik të tregut dhe është një kriter artificial që nuk ka asnjë lidhje me qëllimin e projektit.

Në asnjë projekt të ngjashëm të Komunës së Shtimes apo ndonjë autoriteti tjetër kontraktues nuk është kërkuar dy eskavatorë miniaturë në të njëjtin aktivitet asfaltimi.

Puna e tillë, sipas natyrës dhe përmasave të projektit, mund të kryhet në mënyrë efektive me një mjet standard, dhe kërkesa për “dy” të tilla vetëm thellon dyshimet për përgatitje të specifikimit sipas pajisjeve ekzistuese të një operatori të caktuar ekonomik.

Në mungesë të një analize të justifikuar teknike që ta mbështesë këtë kërkesë, ajo përbën favorizim të qartë dhe cenim të konkurrencës së lirë. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë provë konkrete, asnjë referencë nga paralogaritja, dhe asnjë justifikim teknik që dëshmon se pse kërkohet pikërisht eskavator “deri 1 ton” dhe pse “2 copë”.

Kjo lloj përgjigjeje është stereotipike dhe pa analizë, duke shkelur detyrimin ligjor të arsytimit sipas nenit 10 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në fakt, mungesa e një arsytimi të tillë është vetë prova më e qartë e diskriminimit teknik të kryer.

Ky kufizim:

Nuk ndikon në cilësi apo siguri;

Nuk përmirëson performancën e punimeve;

Por kufizon pjesëmarrjen dhe favorizon një grup të ngushtë operatorësh.

Kjo bie ndesh me frymën dhe tekstin e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, që ndalon çdo specifikim që kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar.

Në mungesë të ndonjë arsye teknike apo projekte që e justifikon, ky kriter përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ndalon specifikime që kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë operatorë të caktuar. Prandaj, kërkohet nga OSHP largimin e këtij kriteri diskriminues.

Nëse AK pretendon se çdo kriter është “në përputhje me paralogarinë”, atëherë duhet të dëshmojë me dokument konkret, jo me deklarata të përgjithshme.

Në të kundërt, refuzimi pa prova materiale bie ndesh me parimin e arsytimit të vendimit administrativ dhe përbën shkelje thelbësore procedurale, që duhet të çojë në anulimin e vendimit dhe rishqyrtim të kritereve diskriminuese.

Pretendimi Ankimor numer 7 :“Cilinder me goma min. 12 ton (1 copë).”

Ky kriter është thellësisht i pasaktë, teknikisht i paargumentuar dhe qartësisht diskriminues, sepse është vendosur pa asnjë analizë profesionale apo projekte që ta justifikojë.

Autoriteti Kontraktues ka parashikuar një kërkesë të përgjithshme dhe të paqartë “cilinder me goma min. 12 ton”, pa specifikuar funksionin teknik nëse kërkohet cilindër me goma për ngjeshjen e shtresave bituminoze (asfaltit) apo cilindër me goma për ngjeshjen e shtresave nën-asfaltike (zhavorr, etj.).

Në praktikën inxhinierike, këto dy pajisje janë tërësisht të ndryshme në funksion, në mënyrën e punës dhe në rezultatin që japin.

- Cilindri për ngjeshjen e zhavorrit ka karakteristika krejtësisht të tjera nga ai për ngjeshjen e asfaltit.
- Kërkesa për “cilinder me goma min. 12 ton” pa e qartësuar qëllimin e përdorimit është një specifikim i papërgjegjshëm teknikisht dhe krijon hapësirë të qartë për interpretim selektiv dhe favorizues në drejtim të një operatori të caktuar që posedon pajisjen “e përshtatshme për tenderin”.

Ky është shkelje e hapur e nenit 7 dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat ndalojnë çdo specifikim teknik që: kufizon konkurrencën, ose krijon avantazh të paarsyeshëm për një operator të vetëm.

Nëse qëllimi është ngjeshja e shtresave nën-asfaltike, atëherë cilindrat me peshë 6–10 ton janë më se të mjaftueshëm dhe të zakonshëm në treg për këtë tip pune.

Nëse qëllimi është ngjeshja e asfaltit, atëherë kërkesa për “12 ton” është sërish pa asnjë bazë, sepse standardet teknike dhe praktikatat e inxhinierisë rrugore nuk e lidhin cilësinë e ngjeshjes me peshën fikse, por me efikasitetin e vibrimit, presionin dhe uniformitetin e ngjeshjes.

Pra, përcaktimi arbitrar i peshës 12 ton dhe mungesa e sqarimit të funksionit të cilindrit:

- krijojnë paqartësi serioze në interpretim,
- kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve që posedojnë pajisje të tjera të përshtatshme,
- dhe përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë në kuptim të Ligjit për Prokurim Publik.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është arsyetuar se “kërkesat janë të bazuara në punët e paramasës dhe paralogarisë”, por në asnjë pjesë të dokumentacionit teknik nuk figuron justifikim për këtë specifikim — as për peshën, as për funksionin, as për nevojën e detyrueshme të një cilindri me goma 12 ton.

Një arsyetim i tillë “standard”, që përsëritet verbërisht për çdo pretendim, nuk përbën as provë teknike, as bazë ligjore për refuzim, por thjesht shmangie nga detyrimi ligjor për të arsyetuar në mënyrë konkrete.

Për këtë arsye, kërkohet nga OSHP: Të riformulohet në mënyrë të qartë dhe profesionale, duke specifikuar llojin e cilindrit sipas fazës së punimeve, ose të hiqet krejtësisht si element teknik i panevojshëm dhe i paargumentuar, SEPSE Ky formulim bie ndesh me nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat ndalojnë specifikime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën ose krijojnë avantazh për subjekte të caktuara.

Çdo vendosje e kritereve pa bazë profesionale është shkelje flagrante e parimit të barazisë dhe transparencës në prokurim, dhe duhet shfuqizuar menjëherë nga OSHP.

Pretendimi Ankimor numer 8 : “Cistern për pastrimin e rrugëve me peshë bartëse 4 ton (1 copë).”

Edhe ky kriter është diskriminues dhe teknikisht i papranueshëm, pasi përcaktimi i peshës fikse 4 ton nuk është i arsyetuar dhe kufizon padrejtësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Vendosja e një vlere të fiksuar (jo minimale apo maksimale) është kundër çdo parimi të proporcionalitetit dhe konkurrencës në prokurim publik.

Në praktikën inxhinierike dhe mekanike, cisternat për pastrimin e rrugëve ekzistojnë në variante të ndryshme – me peshë bartëse nga 3 ton deri në 6 ton – dhe të gjitha kryejnë identikisht të njëjtin funksion teknik: pastrimin dhe shpëlarjen efektive të sipërfaqeve rrugore.

Prandaj, përcaktimi i fiksuar “4 ton” është jorealit, kufizues dhe nuk lidhet me performancën, por vetëm me një parametër arbitrar të peshës, që nuk ndikon në efikasitetin e punës.

Kërkesa e tillë, e pa bazë profesionale, eliminoi automatikisht operatorët ekonomikë që posedojnë cisterna me peshë 3.5 ton, 4.5 ton, apo 5 ton, ndonëse këto pajisje janë teknikisht të barasvlershme dhe plotësisht të përshtatshme për punimet e parapara.

Fakti që kërkohet peshë fikse 4 ton (jo minimum, as maksimum) është indikator i qartë që ky specifikim është formuluar për të përputhur karakteristikat e një pajisjeje ekzistuese të një operatori të veçantë, gjë që bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ky nen ndalon me vendosmëri çdo specifikim që: kufizon konkurrencën, krijon avantazh selektiv, ose e orienton procedurën drejt një operatori të vetëm. Një tender publik nuk mund të jetë konkurs për pajisjen e një subjekti të caktuar, por garë për zgjidhjen më të mirë teknike dhe ekonomike. Autoriteti është arsyetuar se “kërkesat janë të bazuara në paramasë dhe parallogari”, mirëpo nuk përmban asnjë provë konkrete për këtë rast. Në asnjë dokument teknik nuk figuron arsyeja pse peshë fikse 4 ton është domosdoshmëri funksionale për pastrimin e rrugëve. As projekti, as paramasat, as specifikimet nuk kërkojnë asnjëherë peshë fikse, por vetëm pajisje që përmbushin funksionin teknik. Prandaj, arsyetimi i Autoritetit është jo vetëm i pamjaftueshëm, por i pavlefshëm ligjërisht, sepse nuk plotëson detyrimin për justifikim konkret sipas nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky kriter bie ndesh me: Nenin 7 të LPP-së, që ndalon specifikime diskriminuese; Parimin e proporcionalitetit, sepse kufizimi i peshës pa arsye objektive është i paarsyeshëm; Parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, sepse krijon avantazh selektiv për një kategori të kufizuar pjesëmarrësish. Duke qenë se ky kriter nuk përmban asnjë arsyetim teknik, nuk ka lidhje me cilësinë e punimeve, dhe shkel parimet e LPP-së, kërkojmë nga OSHP: Modifikimi urgjent të këtij kriteri, duke e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme si: “Cistern për pastrimin e rrugëve me peshë bartëse minimum 4 ton, ose formulim të ngjashëm që lejon konkurrencë të drejtë dhe pjesëmarrje reale të operatorëve, SEPSE: Ky kriter është një pengesë artificiale, e vendosur në dokumentacion për të orientuar konkurrencën në mënyrë selektive. Në mungesë të arsyetimit teknik dhe bazuar në nenin 7 dhe 59 të LPP-së, kërkojmë shfuqizimin e plotë të këtij kriteri si diskriminues, i paarsyetuar dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

Pretendimi Ankimor numer 9: “Eskavator me goma, lugë rrotulluese 360° i pajisur me GPS 3D (1 copë).” Ky kriter është modeli i pastër i specifikimit diskriminues dhe selektiv, i vendosur pa asnjë bazë teknike, pa arsyetim projektor dhe në kundërshtim flagrant me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Në fakt, ky kriter është më shumë një katalog pajisjesh luksoze sesa një kërkesë reale e projektit për asfaltim e mirëmbajtje rrugësh. Punimet e parapara në këtë projekt : gërmimi, formësimi dhe përgatitja e shtresave rrugore nuk kërkojnë asnjëherë përdorim të një

lugë rrotulluese 360°, e cila është një pajisje e specializuar që përdoret zakonisht për punime të brendshme, ndërtim kanalizimesh në hapësira të ngushta, apo punime urbane të precizionit të lartë. Përfshirja e sistemit GPS 3D në një projekt të këtij lloji është teknikisht e pakuptimtë dhe operativisht e pavlefshme. Në zonat rurale dhe komunale ku realizohen punimet, nuk ekziston sinjal i qëndrueshëm telefoni apo interneti, dhe për trasimin e rrugëve përdoren instrumente standarde topografike (total station) të cilat janë plotësisht të mjaftueshme dhe parashikuara në dokumentacionin teknik të projektit. Prandaj, kërkesa për pajisje GPS 3D që ka kosto shumë të lartë dhe përdoret vetëm në projekte të specializuara të nivelimit automatik, pra ky kriter është kriter luksuz, i panevojshëm, dhe i krijuar për të kufizuar konkurrencën në mënyrë selektive. Vendosja e dy specifikimeve shumë të veçanta në një kombinim të vetëm (“lugë 360°” dhe “GPS 3D”) është një sinjal alarmues i përpjekjes për përshtatje të dokumentacionit të tenderit në favor të një operatori që i posedon këto pajisje të rralla dhe të shtrenjta. Ky është një shembull klasik i kufizimit të konkurrencës, që bie ndesh me frymën e nenit 7 të LPP-së: Argumenti i përsëritur nga ZPP se “kërkesat janë bazuar në punët e paramasës dhe parallogarisë” është retorikë e zbrazët, që nuk përmban asnjë fakt teknik konkret. Në asnjë pjesë të paramasës apo të përshkrimit të punëve nuk kërkohet eskavator me GPS 3D apo lugë rrotulluese 360°. Kjo do të thotë se arsyetimi i Autoritetit nuk e përmbush detyrimin për justifikim specifik, siç kërkohet nga neni 59 paragrafi 4 i LPP-së, dhe rrjedhimisht është i pavlefshëm ligjërisht. Ky kriter: Shkel parimin e proporcionalitetit, sepse kërkon mjete shumë më të avancuara sesa natyra e punimeve; Shkel parimin e trajtimit të barabartë, sepse eliminon operatorët që posedojnë eskavatorë standardë të përshtatshëm; Shkel parimin e konkurrencës së hapur, sepse orienton tenderin drejt pajisjeve specifike në posedim të pak subjekteve. Në dritën e argumenteve të mësipërme, kërkohet nga OSHP që ky kriter të: Hiqet tërësisht nga dosja e tenderit, pasi është teknikisht i pajustificuar dhe ligjërisht diskriminues, OSE Të modifikohet në mënyrë profesionale përshtatshëm: “Eskavator me goma për punime rrugore, me performancë të përshtatshme për gërmim dhe formësim të shtresave rrugore,” pa kufizime të pajisjeve shtesë (lugë 360° apo GPS 3D), që nuk janë kërkesë reale e projektit, SEPSE: Ky kriter nuk është një kërkesë profesionale, por një pengesë artificiale, që nuk ka lidhje me cilësinë e punimeve dhe nuk përmban asnjë justifikim teknik. Në mungesë të bazës ligjore dhe teknike, kërkohet shfuqizimi i tij i menjëhershëm nga dokumentacioni i tenderit, për të garantuar konkurrencë reale, trajtim të barabartë dhe integritet të procesit të prokurimit publik.

Pretendimi Ankimor numer 10: “Buldozher rafshues me ripera, max 3 ton (1 copë).” Ky kriter është teknikisht absurd, juridikisht i paarsyeshëm, dhe praktikisht diskriminues. Në thelb, përcaktimi i peshës maksimale prej 3 tonësh bie ndesh me çdo standard profesional dhe me logjikën funksionale të një projekti që përfshin hapje, rrafshim dhe modelim terreni. Një buldozher me ripera nën 3 ton është pajisje e lehtë, e përshtatshme vetëm për operime të vogla kopshtarie, jo për punime rrugore me gërmime e formësime të shtresave. Pra, përcaktimi “max 3 ton” nuk vetëm që nuk garanton zbatueshmërinë, por e pengon zbatimin teknikisht të saktë të projektit, duke e bërë vetë kërkesën kontradiktore me objektivat e kontratës. Ky kriter bie ndesh me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili ndalon qartësisht specifikime që favorizojnë operatorë të veçantë ose kufizojnë pjesëmarrjen e të tjerëve. Vendosja e një peshe maksimale nuk përbën kriter minimal të kualifikimit teknik, por kriter selektiv, që eliminoi operatorët më të aftë teknikisht, vetëm pse posedojnë pajisje më profesionale. Në thelb, autoriteti kontraktues ka përmbysur logjikën e përzgjedhjes: në vend që të kërkojë mjetet më të afta, ka vendosur kufizim artificial për të përjashtuar mjetet më efikase gjë që është abuzim teknik dhe cenim i konkurrencës reale. Në asnjë pjesë të dokumentacionit të projektit, paramasave apo parallogarisë, nuk gjendet ndonjë arsyetim që kërkon buldozher “maksimum 3 ton”. Në fakt, për të realizuar punët e parashikuara : hapje traseje, përgatitje terreni, rrafshim shtresash nevojitet pajisje më e rëndë dhe më e

fuqishme.Pra, kriteri nuk është “profesional e minimal”, por i kundërt me standardet bazë të ndërtimitarisë rrugore.Ky kriter nuk është as “minimal” e as “profesional” thjeshtë është diskriminues dhe teknikisht i gabuar.Refuzimi i kërkesës tonë për ri-shqyrtim me justifikimin standard “janë kritere minimale dhe profesionale” është i pambështetur dhe përfaqëson refuzim formalist pa arsyetim teknik konkret, në kundërshtim me nenin 96 të Rregullores për Prokurimin Publik, që kërkon arsyetim të bazuar në fakte teknike.Prandaj, kërkojmë nga OSHP që kriteri të riformulohet me peshë minimale (p.sh. min. 3 ton) dhe pa maksimum të panevojshëm, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve të cilët posedojnë pajisje adekuate dhe të përshtatshme për natyrën e punimeve.Ju sqarojmë që ky kriter është shembull tipik i kufizimit të qëllimshëm për përjashtim operatorësh, dhe si i tillë duhet të konsiderohet shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së.Në çdo aspekt teknik, ligjor dhe logjik “max 3 ton” nuk është kriter, por pengesë!

Pretendimi Ankimor numer 11: “Cilinder me rota gome-gome, 3–4 ton (1 copë).”Përcaktimi i intervalit të ngushtë 3–4 ton nuk ka bazë teknike ose profesionale në kuadër të këtij projekti asfaltimi.Punimet e asfaltimit dhe përgatitjes së shtresave mbajtëse mund të realizohen në mënyrë efikase edhe me cilindra me peshë pak më të madhe ose më të vogël, pa kompromentuar cilësinë apo sigurinë e punimeve.DHE Vendosija e një peshë specifike(3-4 tonë) ka efekt diskriminues, duke penguar pjesëmarrjen e shumicës së operatorëve ekonomikë që posedojnë cilindra të përshtatshëm, por jashtë intervalit të specifikuar(3-4 tonë).Pra,ky kufizim krijon avantazh të paligjshëm për një operator të veçantë, duke shkelur parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë, të parashikuara në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.Për të siguruar pjesëmarrje të gjerë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë reale, ky kriter duhet të hiqet ose riformulohet:“Cilinder me rota gome-gome, peshë e përshtatshme për ngjeshjen e shtresave mbajtëse, minimum 3 ton,” që do të sigurojë pjesëmarrje të gjerë dhe trajtim të barabartë të operatorëve, pa kompromentuar cilësinë e punimeve.Ky riformulim ruan funksionin teknik të projektit, pa eliminuar operatorët që posedojnë pajisje adekuate, duke garantuar konkurrencë të drejtë dhe pjesëmarrje reale, SEPSE:Kriteri aktual është artificial dhe i panevojshëm, ndërkohë që refuzimi i pretendimit duke e justifikuar si “kritere minimale dhe profesionale” është i paarsyeshëm.Vendosija e këtij kriteri pengon konkurrencën dhe favorizon operatorë të veçantë, duke shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi Ankimor numer 12: “Dron për matje gjeodezike (1 copë).”Në aktivitetet e mëparshme të Komunës së Shtimes, nuk është kërkuar përdorimi i dronëve për matje gjeodezike. Praktika standarde në terren tregon se GPS Total Station është mjete i duhur dhe i mjaftueshëm për realizimin e pikave gjeodezike në terren, sipas dokumentacionit teknik dhe praktikës inxhinierike.Përdorimi i dronit për matje në këtë projekt nuk sjell asnjë përfitim teknik ose efikasitet shtesë, ndërkohë që:Kufizon pjesëmarrjen e operatorëve që nuk posedojnë pajisje të shtrenjta. Favorizon operatorë të caktuar që kanë akses në teknologji të shtrenjta, duke krijuar avantazh të paligjshëm.Ky veprim bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ndalon vendosjen e specifikimeve të panevojshme që pengojnë konkurrencën dhe favorizojnë operatorë të veçantë.Për të garantuar konkurrencë të drejtë, pjesëmarrje të gjerë dhe trajtim të barabartë, kërkojmë nga OSHP heqjen e plotë e këtij kriteri, SEPSE:Mjeti i përshtatshëm për matjet gjeodezike në këtë projekt është GPS Total Station, që siguron saktësi dhe përputhet me nevojat teknike të punimeve.Ju sqarojmë prapë që kriteri aktual është artificial, i panevojshëm dhe favorizues, ndërkohë që refuzimi i pretendimit duke e justifikuar si “kritere minimale dhe profesionale” është i paarsyeshëm.Heqja e këtij kriteri do të sigurojë konkurrencë të drejtë, pjesëmarrje reale dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, pa kompromentuar cilësinë e punimeve.

Pretendimi Ankimor numer 13: “Finisher me goma 4x4 për shtrirjen e bankinave (1 copë).”Ky kriter është krejtësisht i panevojshëm, teknikisht absurd dhe diskriminues,SEPSE:Së pari, në asnjë projekt të mëparshëm të Komunës së Shtimes nuk është kërkuar përdorimi i finisher me goma 4x4 për shtrirjen e bankinave, duke treguar qartë se ky kriter nuk ka bazë teknike ose praktike. Përdorimi i një finisher të tillë për një punë që kryhet me mjete standarde ndërtimore është plotësisht i tepërt.Së dyti, kërkesa që të jetë 4x4 nuk ka asnjë lidhje me natyrën e punës dhe krijon një avantazh të paligjshëm për operatorë të caktuar që posedojnë këtë pajisje specifike, duke përjashtuar shumicën e operatorëve të tjerë ekonomikë.Së treti, paralelisht, kërkesa për cilindër me rota gome-gome 3–4 ton nuk lidhet aspak me shtruarjen e asfaltit, por është futur në dokumentacion si kriter teknik, duke bërë të qartë që objektivi është të favorizohet një OE specifik dhe jo të kryhen punimet sipas praktikës profesionale.Ky kombinim kriteresh është tendencioz, diskriminues dhe jashtë çdo praktike inxhinierike dhe ligjore që bie edhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, që ndalon vendosjen e specifikimeve të paarsyeshme dhe favorizuese.Prandaj, kërkojmë nga OSHP që kriteri në fjalë të hiqet menjëherë në menyrë që mos të kufizohet konkurrenca për asnjë OE.Ky kombinim kriteresh është tendencioz, diskriminues dhe jashtë çdo praktike inxhinierike dhe ligjore, duke rënë ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ndalon vendosjen e specifikimeve të paarsyeshme dhe favorizuese.Shtrohet, megjithatë një pyetje thelbësore: si është e mundur që Autoriteti Kontraktues –Komuna e Shtimes – në këtë aktivitet prokurimi nuk ka kërkuar “finisher” për shtrimin e asfaltit, që është pajisje e domosdoshme dhe thelbësore për ndërtimin e rrugëve të reja, ndërkohë që ka vendosur si kriter “Finisher me goma 4x4 për shtrirjen e bankinave (1 copë)”?Kjo mospërputhje logjike dhe teknike tregon qartë se kriteret janë përcaktuar pa ndonjë analizë profesionale dhe se qëllimi nuk është realizimi i punimeve sipas standardeve inxhinierike, por favorizimi i drejtpërdrejtë i një operatori të caktuar ekonomik që posedon pajisjen specifike të kërkuar.Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues e ka vendosur vetveten para aktit të kryer, duke e ndërtuar specifikimin teknik në mënyrë që vetëm një ofertues i paracaktuar të mund të plotësojë kriterin. Kjo praktikë bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit, të garantuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi Ankimor numer 14: “Ngarkues me lugë min. 4 m³ me peshore elektronike (1 copë).”Peshoret elektronike përdoren zakonisht në gurthyes ose për matjen e sasisë së materialeve të përgatitura industrialisht, JO gjatë operacioneve standarde të transportit dhe ngarkimit të zhavorrit, gurëve ose materialeve për rrugë.Ngarkuesi me lugë min. 4 m³ është mjete i mjaftueshëm për ngarkimin dhe shpërndarjen e materialeve si zhavorr, apo gurë të thyer gjatë përgatitjes së shtresave mbajtëse dhe bankinave të rrugës.Prandaj,kërkesa për peshore elektronike shërben vetëm për të kufizuar pjesëmarrjen e opertorëve ekonomikë që nuk posedojnë këtë pajisje të shtrenjtë, duke krijuar një avantazh të paligjshëm për një operator të caktuar.Ky kriter bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke qenë një specifikim tendencioz dhe diskriminues, i cili nuk ka asnjë justifikim teknik në projektin aktual.Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ky kriter të hiqet menjëherë dhe ngarkuesi të lejohet të përdoret pa peshore elektronike, duke siguruar pjesëmarrje të drejtë dhe konkurrencë reale për të gjithë operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në tender sepse, Peshorja elektronike në këtë projekt është absurde dhe e panevojshme, dhe kriteri është plotësisht diskriminues Kriteri aktual është absurd, i panevojshëm dhe diskriminues, ndërsa refuzimi i kërkesës tone për ri-shqyrtim duke u justifikuar si “kriterë minimale dhe profesionale” është i paarsyeshëm dhe i padrejtë.Heqja e tij do të sigurojë pjesëmarrje të gjerë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë reale, pa kompromentuar cilësinë dhe efikasitetin e punimeve.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Arsimi Company” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne Dispozitat e shkelura nga AK-ja, Neni 1 i ligjit te prokurimit publik- qëllimi,

Neni 6 i ligjit te prokurimit publik – ekonomiciteti dhe efikasiteti, Neni 7 i ligjit te prokurimit publik-barazia ne trajtim/jo –diskriminim, Neni 28 i ligjit te prokurimit publik- specifikimet teknike, Neni 60 i ligjit te prokurimit publik – Kriteret e dhenies, Neni 69 i ligjit te prokurimit publik – aftësia teknike dhe /ose profesionale Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve. Me respekt të thellë për misionin e OSHP-së në mbrojtje të konkurrencës së ndershme dhe ligjshmërisë,kerkojme qe te merret: V E N D I M te APROVOHET si e bazuar Ankesa e ARSIMI COMPANY SH.P.K. dhe OBLIGOHET AK-KOMUNA SHTIME që përmes formularit të korigjimit të procedures së prokurimit ti largoj kriteret diskriminuese dhe të zgjas afatin e dorezimit të ofertave në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës per rishqyrtim: Kërkesat e percaktuara te mundesit teknike dhe profesionale jane te mbeshtetura në punët e paramases dhe paralogarise të cilat kanë për tu ekzekutuar dhe nuk paraqitet asnje kriter diskriminues dhe nuk cenon te drejten e asnje OE të ofertoj,por janë kriteret minimale dhe profesionale të lemisë së kërkuar në mënyrë që perveç çmimit më të ulet të kemi edhe një Operator ekonomik të pergjegjshem. Të gjitha kërkesat e vendosuar për këtë projekt janë në përputhje me natyren e projektit,dhe janë në harmoni me njësinë kërkuese.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 03.11.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1064/2025, ndërsa me datë 14.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/1064 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, AK pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Arsimi Company” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1064 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Asfaltimi i rruges se Topilles, Caraleve-Zborc dhe Rance-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugeve Rance-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, me nr. të prokurimit: "617-25-3546-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër njoftimit për kontratë, pra kundër kërkesave të dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomik ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk respekton Ligjin e Prokurimit Publik gjatë përpilimit të kërkesave në dosje të tenderit, përkatësisht shkelë nenet: 1,6,7,28,60, 69 dhe 108/A.

Sqarim: Pretendimet e plota ankimore të ankesës janë të parashtruara tek pjesa lartë e raportit "Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore"

Tutje, Operatori Ekonomik ka parashtruar pretendime ankimore lidhur me pajisjet dhe makineritë sipas aneks 1 të DT-së, dhe si e tillë meqë ekspertja shqyrtuese nuk posedon profesionin adekuat, atëherë është kërkuar që të angazhohet një ekspert teknik i fushës për shqyrtimin e pretendimeve ankimore, andaj eksperti teknik shpjegon në vijim.

Eksperti teknik sipas autorizimit për lëndën nr. 2025/1064 të datës 28.10.2025 në pajtim me nenin 114 të LPP i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE të cilat ndërlidhen me "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" neni 91&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional – Kërkesa 6 të Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë.

Eksperti teknik e ka shqyrtuar me kujdes natyrën dhe fushëveprimin e kontratës si dhe kërkesën e dosjes së tenderit duke analizuar përputhshmërinë e kriterëve të përcaktuara në pajtim me fushëveprimin e kontratës. Eksperti po ashtu sqaron se kriteret minimale të përcaktuara në dosjen e tenderit përbëjnë bazën kryesore mbi të cilën është mbështetur edhe vlerësimi i pretendimeve ankimore nga ana e ekspertit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë e drejte dhe përgjegjësi e AK që t'i vendosin varësisht nga natyra dhe fushëveprimi i projektit. Këto kërkesa duhet të jenë në pajtim me kërkesat ligjore konform legjislacionit përkatës, duke siguruar që të ofrojnë mundësi të gjithë ofertuesve potencial trajtim të barabartë dhe jo diskriminues, duke lejuar konkurrencën e hapur në mes OE-ve, (në pajtim me nenin 7 të LPP-se), në shërbim të shfrytëzimit me të drejte të fondeve publike.

Në vazhdim Eksperti teknik paraqet shqyrtimin dhe vlerësimin për të gjitha pikat ankimore:

Pretendimi ankimor 1 – "Rimorkio sinjalizuese për punime në rrugë me gjenerator me regjistrim valid (2 copë)"OE nuk është pajtuar me kërkesën duke e quajtur si diskriminuese dhe ka theksuar se kjo pajisje është e panevojshme për natyrën e projektit. OE ka konsideruar se kërkesat për sinjalizim janë të përkohshme dhe mund të realizohen edhe me pajisje standarde sinjalizuese që janë plotësisht të mjaftueshme për të garantuar siguri në punishten rrugore. Po ashtu OE ka theksuar se kriteri që pajisja të ketë gjenerator të integruar dhe të jetë e regjistruar përbën kriter kufizues.

Përgjigje në pretendimin 1 Eksperti teknik ka analizuar kërkesën dhe konsideron se sinjalizimi i punishtes dhe menaxhimi i trafikut janë kërkesa të domosdoshme në projektet ndërtimore të infrastrukturës rrugore, shpesh mungesa e sinjalistikës ose sinjalistika jo e duhur është faktori kryesor i shkakimit të aksidenteve rrugore në punishte ndërtimore. Duke marrë parasysh natyrën e projektit – ndërtimi i rrugëve është e domosdoshme që pajisjet të jenë sa më të kompletuara dhe të jenë në funksion të plotë gjatë tërë kohës së realizimit të projektit andaj kjo pajisje nuk paraqet kufizim të konkurrencës, por kjo pajisje e rrit nivelin e konkurrencës në sigurimin e punishtes duke sinjalizuar dhe krijuar kushte më të sigurta si për OE punë kryes ashtu edhe për pjesëmarrësit tjerë në trafik.Ndërsa sa i përket kufizimit që pajisja të jetë me gjenerator është kërkesë kufizuese dhe duhet të largohet nga kriteri i kërkesës së DT. AK duhet të përmirësoj kërkesën e DT duke e larguar këtë përshkrim.Vlen të theksohet se në DT AK ka lejuar

bashkëpunimin mes OE me marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve ose marrjen me qira të tyre. Eksperti konsideron se pretendimi 1 pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2 - “Kamion kipper 4x4 me vinç me peshë bartëse deri 5–7 ton (1 copë).” OE konsideron se përshkrimi që pajisja të jetë 4*4 (me lëvizje në të gjitha rrotat) është pa lidhje logjike dhe teknike të projektit duke konsideruar që në projektin ku zhvillohen punimet qasja për pajisje të tillë është e lehtë dhe nuk kërkon mjete për terrene të vështira, po ashtu kërkesa për vinç me peshë bartëse 5-7 ton është interval kufizues duke kërkuar që të lejohen kapacitete me interval më të gjerë.

Përgjigje në pretendimin 2 Eksperti teknik vlerëson se kërkesa e hartuar nga paraqet një kërkesë e cila përfshinë disa kombinime për të cilat vështirë gjinden në treg. Kamionët me vinç zakonisht janë pajisje të rënda andaj kombinimi 4*4+kiper+vinç me ngarkesë 5-7 ton është mjaft specifik, i rrallë dhe në tregun e tonë mund të gjinden me vështirësi. Një përshkrim i tillë i kërkesës mund të jetë kufizues për OE edhe pse është lejuar bashkëpunimi në mes OE-ve, prandaj kjo kërkesë duhet të modifikohet dhe të lejohet mundësia dhe nxitja e konkurrencës reale duke mos e kufizuar pajisjen në 4*4 dhe duke lejuar interval më të gjerë të peshës bartëse të vinçit të paktën 5-10 ton ose në kërkesë të vendos maksimumin ose minimumin e peshës bartëse. AK në kërkesën e dosjes së tenderit mund të kërkojë një kombinim të tillë të pajisjes si Kamion Kipper+Vinç, por duhet lejuar intervalet më të gjera të specifikave për të mundësuar konkurrencën e hapur dhe krijohen kushte më të përshtatshme për pjesëmarrje nga OE të ndryshëm të cilët posedojnë pajisje të ndryshme të kësaj natyre. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 2 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3 - “Kamion kipper me peshë bartëse maksimum 1 ton (1 copë).” OE ankues në pretendimin 3 ka konsideruar se pajisja e tillë në një projekt rrugor nuk ka arsyetim funksional në raport me llojin e punimeve që do të kryhen duke theksuar së një kamion i tillën nuk kapacitet teknik për të kryer ndonjë detyrë reale ndërtimore. OE e ka konsideruar që kriteri është diskriminues dhe në kundërshtim me parimet themelore të konkurrencës. Gjithashtu OE ankues iu ka referuar edhe analogjisë së vendimeve të OSHP-së në lidhje me vlerësimin për këtë lloj pajisje.

Përgjigje në pretendimin 3 Eksperti teknik ka analizuar kërkesën dhe duke u bazuar në vlerësimin e mëparshëm dhe në analogjinë e vendimeve të OSHP vlerëson se kërkesa duhet të modifikohet nga AK të rrisë intervalin e kapacitetit maksimal të pajisjes dhe të lejohet konkurrencën më të gjerë sipas përshkrimit ‘Kamion kipper me peshë bartëse deri në 3.5 ton’. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 3 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4 - “Grejder 10–11 ton (1 copë).” OE ankues ka kundërshtuar kapacitetin kufizues të pajisjes duke e konsideruar që kufizimi i intervalit në vetëm 1 ton diferencë është irracional, favorizon operatorë të veçantë dhe redukton konkurrencën reale në treg.

Përgjigje në pretendimin 4 Eksperti teknik ka analizuar përshkrimin e pajisjes Grejder 10-11 ton, duke marrë parasysh natyrën dhe fushëveprimin e punëve si dhe karakteristikat funksionale të këtyre pajisjeve konsideron se intervali i paraqitur nga AK (10-11 ton) është kufizues duke eliminuar nga gara kapacitetet e grejderëve më të mëdhenj dhe më funksional. Në tregun tonë ka mjaft pajisje të tilla me kapacitete të ndryshme të cilat realizojnë këto punime, andaj kufizimi i diferencës në 1 ton dhe përjashtimi i këtyre pajisjeve nga tregu i punës është kufizues dhe diskriminues për OE. AK duhet të modifikojë kërkesën dhe të mundësojë e të nxisë konkurrencën e drejtë duke specifikuar vetëm kapacitetin minimal të pajisjes min. 10 ton ose duke e rritur intervalin 10-16 ton. Kjo do të lejonte konkurrencën më të gjerë dhe do t’i ofronte operatorëve ekonomik mundësi konkurimi. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 4 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 5 - “Gjysmë-rimorkio për shtrirjen e zhavorit të bankinave, minimum 2 ton (1 copë).”OE ankues ne pretendimin 5 ka kundërshtuar kërkesën për pajisjen në fjalë duke e konsideruar si të pa nevojshme dhe se ky kriter është diskriminues. OE ka kërkuar modifikimin e kërkesës me një formulim të përgjithshëm psh. “ makinë /pajisje e përshtatshme për shtrirjen e zhavorrit të bankinave”.

Përgjigje në pretendimin 5Eksperti teknik ka analizuar natyrën e kërkesës dhe duke e konsideruar fushëveprimin e projektit të ndërtimit të rrugëve një pajisje me përshkrim i tillë është e nevojshme për realizimin e punëve të tilla ndërtimore.Gjysmë-rimorkio për shtrirjen e zhavorrit të bankinave përdoret për shpërndarjen e materialeve si zhavorri ose rëra në anët e rrugës ose në bankinat e saj. Ajo lejon që shtresa e materialit të vendoset në mënyrë të njëtrajtshme dhe të niveluar, duke reduktuar punën manuale dhe duke rritur efikasitetin e punimeve. Pajisja është e përshtatshme në ndërtimin e rrugëve të reja dhe për projektet ku nevojitet shpërndarje e kontrolluar e materialeve në sipërfaqe të kufizuara. Kapaciteti minimal i 2 tonëve lejon transportimin dhe shtrirjen e një sasive të konsiderueshme materialit, duke e bërë punën më të shpejtë, më të saktë dhe me efikasitet të plotë.Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 5 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 6 - “Eskavator me zingjir gome deri 1 ton (2 copë).”OE ankues ka kundërshtuar kërkesën për pajisjen në fjalë duke e konsideruar kërkesë diskriminuese kapacitetin e kufizuar të pajisjes deri 1 ton dhe numrin e kërkuar të pajisjeve të cilën e ka konsideruar si të panevojshme 2 copë.

Përgjigje në pretendimin 6Eksperti teknik ka analizuar natyrën punimeve që realizohen me këtë lloj pajisje dhe duke marrë parasysh që AK në përshkrimin e pajisjes ka vendosur kapacitetin deri 1 ton. Eksperti konsideron se kjo pajisje është e domosdoshme për punët të cilat nevojiten të kryhen për të mos dëmtuar sipërfaqet ekzistuese. Gjithashtu, zingjirët e gomës e bëjnë më të butë lëvizjen mbi asfalt dhe trotuare, duke shmangur dëmtime gjatë punimeve në rrugë. Kjo rrit efikasitetin dhe sigurinë në projektet e ndërtimit të rrugëve. AK në përshkrimin e pajisjes ka vendosur pragun e kapacitetit maksimal të pajisjes duke lejuar OE ofertues të aplikojnë me pajisje me te vogla.Sa i përket numrit te pajisjeve të kërkuara nga AK, eksperti vlerëson se mund të reduktohet në 1 pajisje pasi që volumi i punëve që parashihet të realizohet me këtë lloj pajisje nuk është i madh dhe pa problem realizohet nga 1 pajisje.Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 6 është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 7 - “Cilinder me goma min. 12 ton (1 copë).”OE ankues ka kundërshtuar kërkesën duke e cilësuar të përgjithshme dhe jo të specifikuar qartë përdorimin e pajisjes.

Përgjigje në pretendimin 7Eksperti teknik ka analizuar kërkesën dhe sipas përshkrimit të kërkesës kemi të bëjmë me cilindër me goma për punimet që do të realizohen për rregullimin e bazës së rrugës. Meqenëse përshkrimi i pajisjes është “Cilinder me goma min. 12 ton.”, përdorimi i kësaj pajisje nuk është i kufizuar dhe cilëndo pajisje te cilën e ofrojnë OE ofertues është e pranueshme. Sido qe te jete një kërkesë e tille për pajisje - qoftë për punët e asfaltit apo për rregullimin dhe kompaktesimin e shtresave të bazamentit është e nevojshme për këtë kategori te punëve ndërtimore. Kjo pajisje garanton densitetin e kërkuar dhe stabilitet më të lartë, duke parandaluar deformimet dhe uljet e mëvonshme të rrugës.AK ka përshkruar kufirin minimal të pajisjes dhe sa i përket përcaktimit minimal te pajisjes min12 ton, nuk paraqitet kufizim i konkurrencës pasi qe OE janë te lejuar te ofertojnë me kapacitetet me te mëdha te pajisjes.Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 7 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 8 - “Cistern për pastrimin e rrugëve me peshë bartëse 4 ton (1 copë).”OE ankues nuk është pajtua me përshkrimin e pajisjes pasi që përcaktimi i peshës bartëse 4 ton është fikse dhe kufizon

padrejtësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Përgjigje në pretendimin 8 Eksperti teknik ka analizuar kërkesën dhe vlerëson se përshkrimi është në kundërshtim me legjislacionin përkatës, duke e specifikuar vlerën fikse të kapacitetit të pajisjes. Eksperti e rekomandon AK të bëjë përmirësimin e kërkesës dhe të largoj përcaktimin kufizues të kapacitetit (4 ton), duke vendosë vlerat minimale ose maksimale të kapacitetit të pajisjes (psh. Cisterna për pastrimin e rrugëve me peshë bartëse min. 4 ton) për të lejuar konkurrencën e hapur dhe për t'i mundësuar OE ofertues të aplikojnë në procedurën e prokurimit. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 8 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 9 - “Eskavator me goma, lugë rrotulluese 360° i pajisur me GPS 3D (1 copë).” OE ankues e ka cilësuar këtë kërkesë diskriminuese dhe selektive, e vendosur pa asnjë baze teknike dhe në kundërshtim me legjislacionin për prokurim publik. Gjithashtu ka kundërshtuar edhe përshkrimin e kërkesës për luge rrotulluese 360° dhe te pajisur me GPS 3D, duke i konsideruar shumë specifike të specializuara dhe si te panevojshme për punën dhe projektin ndërtimor që do të realizohet

Përgjigje në pretendimin 9 Eksperti teknik ka analizuar kërkesën për ekskavatorin me goma, lugë rrotulluese 360° dhe pajisje GPS 3D dhe ka vlerësuar se përshkrimi aktual është shumë i specifikuar në raport me përshkrimin dhe punën të cilën e realizon pajisja në fjalë. Eksperti vlerëson se një përshkrim i tillë mund të rrit nivelin funksional të pajisjes por lloji i punimeve që kryhet me këtë pajisje nuk kërkon domosdoshmërisht këtë kombinim funksional të pajisjes. Eksperti sqaron se punët e zakonshme të gërmimit, nivelimit dhe përgatitjes së terrenit mund të realizohen edhe me ekskavatorë të tjerë që nuk e kanë këtë kombinim të veçorive, dhe se specifikat aktuale mund të kufizojnë konkurrencën e drejtë në tender, duke favorizuar një lloj pajisjeje mbi të tjerat. Ai vlerëson se për të ruajtur një konkurrim të hapur, të drejtë dhe për të respektuar parimet e prokurimit publik, është e nevojshme të modifikohet kërkesa dhe të largohen kriteret funksionale që kufizojnë konkurrencën dhe që nuk janë të domosdoshme për realizimin e punimeve. Në këtë mënyrë, do të mundësohet pjesëmarrja e më shumë operatorëve, pa ulur cilësinë apo efikasitetin e punës. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 9 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 10 - “Buldozher rafshues me ripera, max 3 ton (1 copë).” OE ankues e ka cilësuar këtë kërkesë të pa arsyeshme dhe diskriminuese ku përcaktimi i peshës maksimale 3 ton bie ndesh me standardet profesionale. OE e ka cilësuar si pengesë këtë kriter të peshës maksimale në zbatimin e projektit dhe duke e bërë kërkesën kontradiktore me objektivin e kontratës.

Përgjigje në pretendimin 10 Eksperti teknik vlerëson se pajisja e kërkuar sa i përket natyrës dhe fushëveprimit të projektit është e domosdoshme duke siguruar një bazament të rrafshët, duke rritur efikasitetin e punimeve dhe minimizimin për korrigjimet e mëvonshme. AK ka përcaktuar kufirin maksimal max 3 ton, duke lejuar derivimet brenda intervalit të lejuar maksimal, andaj OE ofertues mund të ofertojnë me pajisje brenda këtij kufiri. Një kërkesë e tillë nuk paraqet kufizim të konkurrencës. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 10 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 11 - “Cilinder me rota gome-gome, 3–4 ton (1 copë).” OE ankues e ka cilësuar kriterin kufizues dhe se intervali i ngushtë 3-4 ton nuk ka bazë teknike ose profesionale në kuadër të këtij projekti. Vendosja e peshës (3 -4 ton) ka efekt diskriminues duke penguar pjesëmarrjen e operatorëve tjerë që posedojnë cilindra të përshtatshëm.

Përgjigje në pretendimin 11 Eksperti teknik thekson se AK gjatë përcaktimit të kërkesave duhet të ketë parasysh lejin e konkurrencës sa më të gjerë të OE ofertues. Përcaktimi i kufirit minimal dhe maksimal duhet të lejoj konkurrencën e hapur, mirëpo intervali i përcaktuar në dosjen e tenderit 3-4 ton (që do të

thotë se vetëm dy lloje te pajisjeve mund te përdoren 3 ose 4 ton) është kufizues në vetvete pasi që eliminon nga konkurrimi një pjesë të madhe të pajisjeve të cilat janë të përshtatshme për kryerjen e këtyre punimeve e që kanë kapacitete jashtë këtij intervali. AK gjatë përcaktimit të kriterëve mund të vendos një interval me të gjerë ose të përcaktoj minimumin ose maksimumin e kapaciteteve të pajisjes, për të lejuar një konkurrim të drejtë. Eksperti e rekomandon AK që të beje modifikimin e kërkesës dhe të mundësoj një konkurrencë me të gjere e të drejte duke mos i eliminuar shume pajisje të përshtatshme për shkak të intervalit të kufizuar të peshës. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 11 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 12 - “Dron për matje gjeodezike (1 copë).” OE ankues e ka kundërshtuar kërkesën në fjalë duke e cilësuar se përdorimi i dronit nuk sjell asnjë përfitim teknik ose efikas shtesë, ndërkohë që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, favorizon operator të caktuar dhe përbën diskriminim.

Përgjigje në pretendimin 12 Eksperti teknik ka analizuar kërkesën dhe vlerëson se kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit paraqesin kërkesat minimale të vlerësuara nga AK, andaj në këtë kontekst AK gjatë përcaktimit të kriterëve duhet të vlerësoj kërkesat e nevojshme teknike e profesionale përmes të cilave do të realizohet projekti. Droni për matje gjeodezike përdoret për të bërë matje të sakta të terrenit dhe për të krijuar hartat digjitale të zonës ku do të ndërtohet rruga. Ai mundëson përcaktimin e lartësive, pjerrësive të terrenit në mënyrë të shpejtë dhe të saktë, pa nevojën e matjeve manuale të terrenit. Përdorimi i dronit është i arsyeshëm sepse rrit precizitetin, ndihmon në planifikimin e rrugës dhe zvogëlon gabimet në nivelimin e bazamentit, duke kursyer kohë dhe resurse si dhe duke e bërë procesin më efikas dhe të kontrolluar. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 12 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 13 - “Finisher me goma 4x4 për shtrirjen e bankinave (1 copë).” OE ankues e ka cilësuar këtë kriter si të panevojshëm teknikisht, duke e konsideruar si kriter diskriminues. OE ankues kombinimin e këtyre kriterëve e ka quajtur si tendencioz, diskriminues dhe jashtë çdo praktike inxhinierie e ligjore.

Përgjigje në pretendimin 13 Eksperti teknik duke u bazuar në natyrën dhe fushëveprimin e projektit konsideron se për shtrimin e bankinave mund të përdoren edhe pajisje të tjera alternative si buldozer rrafshues ose ekskavatorë të përshtatur me pajisje nivelimi, mirëpo sa i përket punimit të bankinave finisher-i është më efikas dhe garanton shtresat uniforme të bankinave me trashësi të njëtrajtshme. Pajisjet alternative mund ta bëjnë punën e njëjtë të bankinave, por nevojitet me më shumë kohë, dhe nuk mund të kenë efikasitetin e njëjtë, përderisa duhet të bëhen korrigjime manuale për shkak jo uniformitetit të shtresës dhe pasaktësisë, ndërsa finisher-i e automatizon procesin dhe zvogëlon gabimet gjatë realizimit të punimit të bankinave. Në këtë kontekst si në aspektin profesional dhe teknik një pajisje e tillë përshpejton procesin e punës dhe rrit efikasitetin dhe cilësinë e punimeve. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 13 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 14 - “Ngarkues me lugë min. 4 m³ me peshore elektronike (1 copë).” OE ankues e ka kundërshtuar kërkesën duke dhënë argumentet e mjaftueshme për të qartësuar se përshkrimi i kërkesës është diskriminues dhe kufizon konkurrencën e drejtë. OE nuk është pajtuar me kërkesën për peshoren elektronike që duhet të ketë pajisja e kërkuar, pasi që kjo shërben vetëm për të kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik që nuk posedojnë një pajisje të shtrenjtë duke krijuar avantazh të paligjshëm për një operator të caktuar.

Përgjigje në pretendimin 14 Eksperti teknik ka vlerësuar kërkesën dhe konsideron se përshkrimi i kërkesës është i kufizuar në përfshirjen e peshores elektronike. Peshorja elektronike mundëson matjen me të saktë

të materialeve, mirëpo në kuadër të realizimit të punëve ndërtimore në shtrimin e rrugëve kjo pajisje është e panevojshme. Puna e ngarkimit mund të kryhet pa kurrfarë problemi edhe me ngarkues standardë pa peshore. Eksperti i rekomandon AK-së që të bëjnë modifikimin e kërkesës duke përkthyer “ Ngarkues me lugë min. 4 m³ “. Eksperti teknik vlerëson se pretendimi 14 është i bazuar. Eksperti teknik informon ekspertin shqyrtues dhe propozon që ankesa e operatorit ekonomik të pranohet pjesërisht e bazuar. AK të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit tek kriteret teknike dhe profesionale.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00€” me nr. të prokurimit: 617-25-3546-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Asfaltimi i rrugës së Topillës, Caralevë-Zborc dhe Rancë-Greçeve, Komuna e Shtimes Asfaltimi i rrugëve Rancë-Greçeve Lot-I 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugës Topillës Lot-II 410,000.00 €, Asfaltimi i rrugëve Caralevë-Zborc Lot-III 100,000.00€” me nr. të prokurimit: 617-25-3546-5-1-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton qe ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SHTIME**
- **OE - Arsimi Company SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: